


**DUHET NJË BOTË E TËRË
KUNDËR DHUNËS NDAJ FËMIJËVE**

Dhuna, në të gjitha format e saj, është ndër problemet që prek më tepër fëmijët në ditët e sotme. Dhuna i zhvesh fëmijët nga dinjiteti, nga të drejtat, nga potenciali, nga e ardhmja... Ajo i rrezikon dhe i cënon të ardhmen.

Në të gjithë vendin, rezulton se 70 % e fëmijëve përjetojnë një formë dhune, të cilën nuk e raportojnë. 80% e prindërve pranojnë se e kanë përdorur dhunën si formë disiplinimi. Sot kemi fëmijë të neglizhuar që përballen me të gjitha format e dhunës, fëmijë që dhunojnë njëri-tjetrin, apo mësues e kujdestarë që përmes dhunës kërkojnë të sjellin edukimin.

Kjo duhet të marrë fund...

Duhet një botë e tërë për t'i dhënë fund dhunës ndaj fëmijëve, duhet një botë e tërë për të ndryshuar sjelljet, për të edukuar shoqërinë që dashuria është e vetmja rrugë që në të ardhmen të kemi fëmijë që jetojnë të mbrojtur në familje, në shkollë dhe në komunitete. Fëmijët duhet të jetojnë jetën e tyre në plotësi.




VIZIONI YNË

**Vizioni ynë për çdo fëmijë, jeta në tërësinë e saj...
...Lutja jonë për çdo zemër, dëshira për ta bërë
atë realitet.**



It takes a world to end violence against children



70%

e fëmijëve raportojnë se kanë përjetuar të paktën një herë një formë dhune gjatë vitit të fundit

16.4% e fëmijëve raportojnë që janë **qëlluar me shuþlaka, grusht apo shqelma**


6.4% janë **rrahur me rrip** apo me shkop

36.5% e fëmijëve pohojnë se kanë qenë **objekt talljeje** gjatë vitit të fundit

38% e fëmijëve pohojnë se **u kanë bërëtitur** apo i kanë **ofenduar**



18% e fëmijëve të moshës 8-15 vjeç raportojnë se punojnë



Të paktën një herë dhunë

PRINDËRIT

80% e prindërve ose kujdestarëve raportojnë se e **kanë përdorur dhunën** si mjet disiplinimi

Fëmijë të neglizhuar

39.7% e prindërve raportojnë se i kanë **neglizhuar** në ndonjë mënyrë fëmijët e tyre



SHKOLLA



Të pasigurtë në shkollë

56% e fëmijëve raportojnë se **nuk ndihen gjithnjë të sigurtë** në ambientet e shkollës.

67%
e fëmijëve

raportojnë se nuk e konsiderojnë lagjen si një vend gjithmonë të sigurtë.

KOMUNITETI



SA RAPORTOHET DHUNA?



42% kanë frikë të raportojnë raste të abuzimit


46% janë indiferentë për të raportuar rastet e abuzimit

34% nuk kanë besim të raportojnë tek institucionet



SI NDIHMON WORLD VISION?

Ne punojmë në partneritet me aktorët kyç për të adresuar çështjet e mbrojtjes së fëmijëve përgjatë zinxhirit të kujdesit.



NE E BËJMË KËTË NËPËRMJET:

FUQIZIMIT TË VAJZAVE DHE DJEMVE

Përmes zhvillimit pozitiv, aftësive për jetën dhe ndërtimit të kapacitetit të tyre për të qenë aktorë mbrojtës dhe me ndikim në komunitetin e tyre.

FORCIMIT TË FAMILJES

Nëpërmjet mbështetjes së prindërve në mënyrë që familja të jetë e shëndetshme dhe të respektojë, ushqejë dhe të mbrojë të gjitha vajzat dhe djemtë.

PARTNERITETIT ME KOMUNITETIN

përmes dialogut të qëndrueshëm dhe veprimit kolektiv për të promovuar norma pozitive, sjellje mbrojtëse dhe mekanizma mbrojtës.

NDIKIMIT TEK INSTITUCIONET PËRKATESE




përmes përgjegjësisë sociale në të gjitha nivelet për të marrë masat e duhura për të siguruar mbrojtjen e vajzave dhe djemve.



World Vision është një organizatë zhvillimi komunitar, e krishterë, humanitare dhe advokative. Prej dy dekadash ne punojmë me 32 mijë fëmijë, në 220 komunitete në nevojë. World Vision njihet në komunitet si mobilizues dhe ndërlidhës i tyre me institucionet dhe organizatat për çështje që prekin jetën e fëmijëve. Gjatë kësaj periudhe kemi bashkëpunuar me 56 organizata, 18 kisha dhe organizata me bazë besimi.

Pjesë e punës sonë prej vitit 2012 është dhe publikimi në mënyrë periodike i Raportit mbi Situatën e Mirëqenies së Fëmijëve në Shqipëri* (Child Well-Being Report) në zonat ku World Vision punon. Sipas të dhënave të këtij Raporti për vitin 2016-2017.




 Syri rastin
 e shikon.
 Goja rastin
 e raporton.
 Policia rastin
 e shpëton.

Komenda mbi të dytë
 e familjes
 Në paragrafën 2, 3 të Konventës,
 Neni 84 thotë se: "Mij element tjetër
 i marrëdhënimit të familjes konflikt
 për të dytë e korrelata që gjegjësi
 familjet e lenda fortë montat me dhe
 të lenda nga montata.
 - Shprehjet primaris, shprehjet, hapshëmimi,
 shprehjetimi dhe shprehjetimi për punë
 familjes tregj shprehjet me llogj."








Të jesh familje
 është të

 mos e harrosh kur
 atë.
 P. Jashe Doraku Doraku
 Rejdi Muca ia





Kristina është 14 vjeç, jeton në Librazhd dhe prej 2 vitesh është pjesë e blogut “Reporter” të World Vision. E pasionuar pas gazetarisë, ajo është vazhdimisht në kërkim të formave të reja për të ngritur zërin në lidhje me problematikat që shqetësojnë atë dhe moshatarët e saj. Për këtë arsye ka sjellë të projektuar në një foto-ese, varësinë e adoleshentëve ndaj internetit dhe shqetësimin e rrezikut që vjen nga përdorimi i pakontrolluar i tij.



Interneti, zhvillim por dhe rrezik

Sot librat janë zëvendësuar nga interneti, gjumi është zëvendësuar nga celulari, madje edhe vetë ne po zëvendësohemi nga jeta virtuale. Një pjesë e mirë e adoleshentëve në ditët e sotme kanë krijuar një varësi të madhe ndaj internetit dhe jo pak herë, lundrimi i pakontrolluar në internet krijon ndjesinë e të qenit të pambrojtur, bën që adoleshentët të bien pre e abuzimeve. Shumica e prindërve sot mundohen t'i mbrojnë fëmijet e tyre nga ky rrezik, jo gjithmonë ia dalin mbanë. Mesazhi im është që duhet të jemi ne fëmijët që të tregohemi më të kujdeshëm.

Kristina - Blogu “Reporter”, Librazhd

Dhuna ndryshe

“Dhunë...”, “u dhunua...”, të gjithëve na shkon në mendje dhuna fizike dhe harrojmë krejtësisht format e tjera të saj. Rinia e sotme, fëmijët nga mëngjesi në mbrëmje, janë përballë saj. Dëshirat e ndrydhura, mlllefet shoqërore përballë pamundësive që u ofrohet bëjnë që ata të jenë përballë dhunës psikologjike. Përballë gjithë kësaj, cili është pozicioni i fëmijës? A e ka përkrahjen e duhur? Në mendje më vjen rasti i një vogëlushi, i gjendur mes katër udhëve, përballë gjithë formave të dhunës që haste çdo moment në komunitetin tim.

Një faleminderim personal shkon për grupin IMPACT të të rinjve që unë drejtoj. Kur ky rast u evidentua prej atyre, u kontaktuan instancat përkatëse të pushtetit vendor dhe vogëlushi u shpëtua, u kthye në shtëpi. Pyes veten: “Po nëse World Vision mos shërbente me korrektesë në projektet e saj komunitare, cili do ishte fati i atij vogëlushi? Do kishim mundësi unë së bashku me grupin e të rinjve të identifikonim dhe zgjidhnim këtë problem?”

Ne, si shoqëri, jemi rritur “të lidhur në djep” që në vogëli dhe mundësitë i kemi të kushtëzuara dhe e gjitha kjo përkthehet në impulsivitet të dhunshëm. Bashkëpunimi mes të gjithë aktorëve lehtëson këtë plagë të madhe. Ju lutem, bëni kujdes! Mos dhunoni qoftë dhe me një fjalë!

Sokol Dosku

IMPACT Lider, fshati Dorëz, Librazhd



DHUNA TE FËMIJËT

Dhuna godet aty ku asnjëri nuk e mendon. Ajo, në shumicën e rasteve lind momentalisht dhe përhapet në mënyrë tronditëse. Ajo përfiton atëherë, kur çdo gjë i lihet rastësisë duke u shmangur nga puna konkrete si dhe nga boshti edukativ. Dhuna në shoqërinë shqiptare të ditëve tona po prek pothuajse të gjithë sistemin e marrëdhënieve ndërmjet njerëzve. Mësuesi si mësues dhe edukator duhet ta njohë këtë fenomen dhe mbi gjithçka duhet të luftojë për ta minimizuar. Gjithë puna edukative kryesisht në shkollë, po ashtu edhe në familje duhet bërë në funksion të shmangies së këtij fenomeni. Mësuesi duhet ta ketë të qartë dhe gjithnjë duhet të luftojë me të gjitha mjetet për të kontrolluar e shmangur këtë fenomen. Tek fëmijët fenomeni i dhunës ka ndikim më të madh dhe të drejtpërdrejtë. Ky fenomen mund të shkaktojë pasoja deri edhe të pariparueshme për jetën dhe veprimtarinë e mëvonshme të fëmijës. Pasojat janë të ndryshme si çrregullime në sjellje, vështirësi në marrëdhënie me bashkëmoshatarët, probleme me gjumin, probleme me ushqimin, ndjesinë e të qenit fajtor, vetëvlerësim i ulët...

Ndikimi i dhunës ka aspekte të cilat te fëmijë të veçantë krijojnë stres, krijojnë frikë duke e shmangur nga misioni që ka ai apo familja për shkollën dhe jetën. Dhuna si verbale dhe fizike, shfaqet në mënyra të ndryshme, por dëmton njësoj, prek familjen, individin dhe shoqërinë nesër. Dhuna, si fenomen, ndikon aq shumë te një fëmijë sa që mund ta detyrojë atë të kthehet nga i dhunuar në dhunues. Dukuri të tilla kanë qenë sporadike, por kanë marrë përmasa të mëdha kur ajo është nënvlerësuar. Dhuna në shkollë përfshin një sërë sjelljesh, të cilat kërcënojnë dhe lëndojnë fëmijët fizikisht dhe emocionalisht. Mësuesi duhet ta shikoj këtë fenomen në çdo hap të punës së tij, duke treguar angazhim dhe fleksibilitet të mirëpranuar dhe mirëorganizuar. Ai së pari duhet të luftojë fenomenin dhe më pas të shmangë ndikimet negative duke rritur fëmijë me horizont dhe ndjeshmëri të lartë. Thuhet se “edukimi fillon njëzet vjet para se të lind fëmija” dhe ky është burimi më i begatshëm për t’ju shmangur dhunës. Një edukim i brezave i bazuar në parime të shëndosha humane prodhon njerëzimin me vlera dhe ndjenja cilësore, që mënjanon dhunën fizike dhe verbale. Në sytë e mësuesit nën vëzhgimin e tij duhet të kalojë çdo gjë, duke përçuar ide e mendime pozitive. Në sytë e mësuesit fëmija duhet të shihet si bartës i cilësive më të pastra shpirtërore.

PËLLUMB GJURA

Mësues, fshati Kuturman, Librazhd



LIGJI "PËR TË DREJTAT DHE MBROJTJEN E FËMIJËVE" NË GJUHËN E FËMIJËVE

"Kthimi i ligjit "Për të drejtat dhe Mbrojtjen e fëmijëve" në një gjuhë miqësore është një nismë, ku fëmijët janë kontribuesit kryesorë. Gjatë procesit të konsultimit, ata kanë dhënë sygjerimet e tyre se si ky ligj mund të jetë sa më i kuptueshëm për të gjithë fëmijët, por dhe për të përshtatur sipas nevojave të tyre, politika apo ligje që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e tyre.

Çfarë ndodh nëse ju nevojitet mbrojtje?

- Një fëmijë mund të ketë nevojë për mbrojtje të veçantë për shkak të vdekjes së prindërve, neglizhimit ose abuzimit brenda familjes, ose prindër në konflikt me ligjin.
- Fëmijët në një situatë të dhunshme në shtëpi mund të largohen nga familja e tyre për një kohë të shkurtër për t'i mbajtur të sigurt.
- Këta fëmijë mund të vendosen në përkujdesje alternative ose të qëndrojnë në shtëpi nën mbikëqyrjen e një punonjësi për mbrojtjen e fëmijës.
- Fëmijët kanë të drejtën e një plani individual të mbrojtjes të hartuar nga një Punonjës për Mbrojtjen e Fëmijës, së bashku me ju dhe kujdestarët tuaj
- Prindërit mund të marrin mbështetje për t'i ndihmuar ata të bëhen më mirë dhe të ribashkohen me fëmijët e tyre.
- Të gjitha shërbimet në këtë plan ofrohen falas.

Nenet 53-61

Fëmijët që kanë nevojë për mbrojtje të veçantë

- Viktima të abuzimit, neglizhimit, keqtrajtimit dhe dhunimit;
- Fëmijët që jetojnë dhe punojnë në rrugë, ose shfrytëzohen dhe trafikohen për punë ose marrëdhënie seksuale.
- Fëmijët që kanë kryer vepra penale.
- Ju gëzoni të drejtë t'i tregoni Punonjësit për Mbrojtjen e Fëmijës për një situatë të dëmshme.
- Punonjësit për Mbrojtjen e Fëmijës mund të vizitojnë një shtëpi nëse raportohet një rast abuzimi dhe të vendosin mbi vepërimit që duhet të ndërmerren.
- Punonjësit për Mbrojtjen e Fëmijës shkojnë në rrugët ose në vendet, ku janë raportuar raste të shfrytëzimit ekonomik.
- Të gjithë fëmijët që kanë nevojë për mbrojtje të veçantë kanë të drejtë të marrin mbështetjen e duhur mjekësore, psikologjike ose këshillimore.

Nenet 62 – 66

Kush është përgjegjës për të të mbrojtur ty?

- Përveç prindërve tuaj dhe anëtarëve të familjes, ka dhe njerëz të tjerë që mund t'ju ndihmojnë dhe t'ju mbrojnë.
- Kjo përfshin Njësinë për Mbrojtjen e Fëmijës dhe Njësinë për Vlerësimin e Nevojave dhe Referimit. Punonjësi për Mbrojtjen e Fëmijës punon për këto njësi.
- Nëse jeni i shqetësuar për një nga miqtë tuaj ose veten, ju duhet të kontaktoni Punonjësin për Mbrojtjen e Fëmijës.

Nenet 34 – 52

Si mund ta raportoni dhunën kundër fëmijëve?

- Secili ka për detyrë të raportojë rastet e dyshuara të përdorimit, neglizhimit ose shfrytëzimit të fëmijës në strukturat përkatëse të mbrojtjes së fëmijës.
- Nëse shihni një fëmijë në rrezik, bisedoni me dikë tek i cili keni besim në shkollë ose në Njësinë e Mbrojtjes së Fëmijëve ose telefononi në linjën telefonike. Ju mund të raportoni duke e ditur se do të ruhet privatësia e emrit tuaj.
- Linja telefonike për fëmijët. Një linjë telefonike 24 orë falas është në dispozicion për fëmijët në mënyrë që ata të mund të raportojnë rastet.

Numri i linjës: 116111

- Ajo do t'i referojë rastet e raportuara Njësive për Mbrojtjen e Fëmijës.

FJALËKRYQ

Horizontalisht

1-Lumturia e çdo prindi

4-Mban përgjegjësi për mirëqenien e komuniteteve të saj


5-Miku ynë me uniformë

7-Zgjidh problemet tona shpirtërore


Vertikalisht

3-Ngrohtësia dhe dashuria që pret fëmijë

6-Vendi ku marrim dije



LABIRINT





“Materialet e kësaj reviste janë realizuar me ndihmën e fëmijëve të grupeve IMPACT për mbrojtjen e fëmijëve në Librazhd. Ky është një botim i World Vision Albania and Kosovo dhe në të gjitha rastet ai shpërndahet falas”.